



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.3602/24 prot.

Datë 28.03.2025

V E N D I M
Nr. 423/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 28.03.2025, mori në shqyrtim çështjen me,

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.366/2025, datë 13.03.2025, për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-20989-09-20-2024, me objekt: “Rikonstruksion i Kopshtit Nr.3, lagjia Nr.5”, me fond limit 69,751,108.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 10.10.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kukes
- Ankimues:** BOE “Denolt” SHPK dhe “Llazo” SHPK me NIPT K48021210Q dhe K24218401K si dhe adresë: Kukes,Kolsh, Lagjia Todaj, Rruga Nacionale Kukes-Tirane Km5, Ndertese Nr.1
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Kukes me adresë: Sheshi “Skenderbej”, lagjia Nr.5, Kukes
- Subjekte të Interesuara:** Operatori ekonomik “Xhast” SHPK me NIPT K12512837I dhe adresë: Tirane, Njesia Bashkiake Nr.11, Rruga Don Bosko, Objekt me Zone Kadastrale Nr.8330, Pasuri me Nr.9/576
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për

Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 13.03.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.366/2025, ku vendosi:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën me numër ankimi elektronik A/2024/4875 datë 10.12.2024 dhe me nr. 3602/1 prot., datë 11.12.2024 të BOE ankimues “Denolt” SHPK dhe “Llazo” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-20989-09-20-2024, me objekt: “Rikonstruksion i Kopshtit Nr.3, lagjia Nr.5”, me fond limit 69,751,108.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 10.10.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kukes.
2. Të mos pranojë ankesën me numër ankimi elektronik A/2024/4875 datë 10.12.2024 dhe me nr. 3602 prot., datë 10.12.2024 të BOE ankimues “Denolt” SHPK dhe “Llazo” SHPK për procedurën e prokurimit të sipërcituar.
3. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit dhe me rihapjen e procedurës të ketë parasysh konstatimet e mësipërme të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. T’i propozojë Agjencisë së Prokurimit Publik nisjen e hetimit administrativ për konstatimet e mësipërme, si edhe të dërgohet pranë APP-së kopje e materialeve të administruara në këtë shqyrtimin administrativ.
6. Ngarkohet zyra e financës, të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga BOE ankimues “Denolt” SHPK dhe “Llazo” SHPK.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr.1953 prot., datë 25.03.2025, protokolluar me tonën nr. 3602/21 prot., datë 27.03.2025, autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 366/2025 datë 13.03.2025.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1. Me shkresën nr.1953 prot., datë 25.03.2025, protokolluar me tonën nr. 3602/21 prot., datë 27.03.2025, autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 366/2025 datë 13.03.2025.

II.2. Nga verifikimi i raportit të auditit në sistemin e prokurimit elektronik, si dhe informacioni i dërguar nga autoriteti kontraktor, KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka anuluar procedurën e mësipërme të prokurimit në përputhje me vendimin e KPP-së Nr.366/2025 datë 13.03.2025.

II.3. Sa më sipër, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor, ka zbatuar vendimin Nr.366/2025 datë 13.03.2025 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-20989-09-20-2024, me objekt: “Rikonstruksion i Kopshtit Nr.3, lagjia Nr.5”, me fond limit 69,751,108.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 10.10.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kukes.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-20989-09-20-2024, me objekt: “Rikonstruksion i Kopshtit Nr.3, lagjia Nr.5”, me fond limit 69,751,108.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 10.10.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kukes.
 2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaid Myzyri

